

**VENDIM**  
**Nr. 268, datë 27.4.2023**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 247, DATË  
30.4.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E  
RREGULLAVE, TË KËRKESAVE E TË PROCEDURAVE PËR INFORMIMIN  
DHE PËRFSHIRJEN E PUBLIKUT NË VENDIMMARRJEN MJEDISORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 17, të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 247, datë 30.4.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Kudo në tekstin e vendimit:

a) emërtimi “Ministria e Mjedisit” zëvendësohet me fjalët “...ministra përgjegjëse për mjedis in ...”;

b) emërtimi “Agjencia Rajonale e Mjedisit” dhe shkurtimi “ARM” zëvendësohen, përkatësisht, me “Drejtoria Rajonale e Mjedisit” dhe “DRM”;

c) fjalët “... qeverisjes vendore ...” zëvendësohen me “... vetëqeverisjes vendore ...”;

ç) fjala “shënim” zëvendësohet me “procesverbal”.

2. Në kreun I bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “a”, e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Informimin dhe marrjen e mendimit të publikut nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) për projektet, që AKM-ja vlerëson se ato mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në mjedis, bazuar në listën e shtojcës II, të ligjit nr. 10440 datë 7.11.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, të shoqëruar me sqarimet për procedurën në zbatim.”.

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Në rastet kur AKM-ja vlerëson se projekti ka ndikim të konsiderueshëm në mjedis, publikon menjëherë në faqen e saj të internetit informacionin e plotë për projektin, siç është paraqitur nga zhvilluesi.”.

c) Shkronja “c”, e pikës 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) mënyrën dhe afatin e ankimit, brenda 30 ditëve nga publikimi i vendimit të titullari i AKM-së, ndaj vendimit dhe procedurës së zbatuar nga AKM-ja për marrjen e vendimit, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Administrative.”.

ç) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Në përfundim të procedurës paraprake të VNM-së, AKM-ja gjatë marrjes së vendimit vlerëson komentet apo sugjerimet e dhëna nga publiku/palët e interesuara për projektin dhe procedurën paraprake të ndjekur gjatë fazës, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij kreu. Vendimi i AKM-së publikohet i plotë në faqen e saj të internetit, ku publiku dhe palët e tjera të interesuara sigurojnë një kopje të plotë të tij.”.

3. Në kreun II bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja “ç”, e pikës 2.1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) mënyrën e ushtrimit të së drejtës së ankimit ndaj procedurës së pjesëmarrjes së publikut dhe deklaratës mjedisore, brenda 30 ditëve nga publikimi i deklaratës.”.

b) Në pikën 2.3, pas fjalëve “... njësitë administrative vendore ...” shtohen “... dhe palët e interesuara ...”;

c) Në fund të shkronjës “b”, të pikës 4.1, shtohen fjalët “... të paktën 20 (njëzet) ditë nga publikimi i informacionit të plotë mbi projektin e paraqitur në AKM.”;

ç) Shkronja “dh”, e pikës 4.2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“dh) Merr në konsideratë rezultatet dhe sugjerimet e publikut apo argumenton arsyet e mosmarrjes në konsideratë të kërkesave të tyre gjatë shqyrtimit për deklaratën mjedisore dhe procesit të VNM-së;”.

d) Pas pikës 7.6 shtohet pika 7.7, me këtë përmbajtje:

“7.7 Procesi i zhvillimit të seancës dëgjimore për projektin e propozuar është i vlefshëm brenda 1 viti nga data e realizimit, kur:

- i. zhvilluesi tërhiqet nga zhvillimi i projektit, pas përfundimit të procesit të dëgjësës publike;
- ii. zhvilluesi është pajisur me deklaratë mjedisore për refuzimin e kërkesës për leje/licencë zhvillimi për atë projekt, shkakët e së cilës nuk cenojnë interesat e publikut dhe palëve të interesuara, sipas procesverbaleve dhe raporteve të përgatitura gjatë procesit të zhvillimit të seancës dëgjimore. Në këtë rast, procesi i zhvillimit të seancës dëgjimore është i vlefshëm edhe kur zhvilluesi rifillon procedurën për pajisjen me deklaratë mjedisore, brenda 1 (një) viti nga realizimi i këtij procesi.”.

4. Pika 2.1, e kreut III, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2.1 Çdo palë e interesuar ka të drejtën e ankimit administrativ ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve dhe/ose veprimit procedural gjatë zhvillimit të procedurës së informimit dhe pjesëmarrjes së publikut në procesin paraprak dhe të thelluar të VNM-së, në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe Kodit të Procedurës Administrative. Ankimi administrativ paraqitet te ministri brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e shpalljes së deklaratës mjedisore.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**